



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:056556

Datë: 25.05.2022

Numri i dokumentit: 03052953

PKR.nr.66/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, me Kryetarin e Trupit Gjykes – Gjykatësi **Drilon Haraçia**, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, kundër të akuzuarve A. B. nga Gjakova dhe K. N. nga fshati O., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 296 prg.2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/I.nr.145/2022, të datës 20.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar **me datën 12.05.2022**, në prezencën e Prokurores së Shtetit Dëshire Jusaj, si dhe të akuzuarit A. B. dhe mbrojtësit të tij av.Meshari Selimaj nga Gjakova sipas autorizimit dhe të akuzuarit K. N. dhe mbrojtësit të tij av.Avdi Rizvanolli nga Gjakova, i caktuar sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë, ndërsa u përpilua **me dt.25.05.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

A. B., nga i ati B. dhe nëna V., e gjinisë B., i lindur më dt.... në Gjakovë me banim në rr."F. I." p.n, me nr. personal:, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me profesion i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës të Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 23.03.2022 gjer me dt.12.05.2022

K. N., nga i ati P. dhe nëna L., e gjinisë U., i lindur më dt.03.03.2003 në Gjakovë, me banim në fsh. O. Komuna e Gjakovës, me nr. Personal:, vazhdon shkollën e mesme-viti i 3-të, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës të Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 23.03.2022 gjere me dt.12.05.2022.

J A N Ë F A J T O R

I akuzuari A. B.

I. Sepse me datë të pacaktuar e deri me dt.23.03.2022 nga shtëpia e tij në Gjakovë në rr.“Ferid Imami”, vë në qarkullim parat e falsifikuara duke e ditur se janë të falsifikuara me qëllim për ti vënë vetës apo tjetrit përfitim të kundërligjshëm pasuror, e të cilat para i kishte siguruar nga të tjerë persona, ka vë në qarkullim duke shitë me çmim më të lirë monedha nga 100 Euro në shumë të pa përcaktuara tek personi K. N. e njëjtë me shitje ka vepruar edhe K. tek te miturit e tjerë, për çka pas njoftimit të policisë me rastin dhe ndërmarrjes së menjëhershme veprimeve rezulton se i pandehuri i ka shitur personit të pandehurit K. N. 18 monedha nga 100 Euro të falsifikuara me çmim prej 20 Euro për copë e që më pas ky blerës i ka shitë këto monedha tek i mituri F.G. nga fshati M., K. Gjakovë në shumë prej 25 Euro duke vazhduar kështu shitja tek blerësit e tjerë të mitur, ashtu që nga patrullimet e kryera policore, të pandehurit A.B. i janë gjete në xhepin e jaknes gjashtë (6) monedha nga 100 euro të falsifikuara me nr..... – pesë (5) monedha dhe një (1) monedhë me numër si dhe 440 Euro para origjinale të cilat i sekuestrohen për shkak të përfitimit me marrjes së parave të falsifikuara, vënies së tyre në qarkullim për të vërteta, transportimit, përdorimin dhe shitjes së tyre edhe pse në dijeni se një veprim i tillë është i kundërligjshëm, siç është konstatuar edhe nga Raporti i Ekspertimit të Agjencionit të Kosovës për Forenzikë AKF-2022-1125/2022-1000 me datë.05.04.2022.

- **Me çka ka kryer veprën penale falsifikim i parasë nga neni 296 parg.2 të KPRK-së.**

I akuzuari K. N.

II. Sepse me datë të pacaktuar e deri me dt.23.03.2022 në Gjakovë, vë në qarkullim parat e falsifikuara duke e ditur se janë të falsifikuara me qëllim për ti vënë vetës apo tjetrit përfitim të kundërligjshëm pasuror, në atë mënyrë ka vë në qarkullim parat të cilat i kishte blerë nga i pandehuri A. B. dhe kështu i ka përdorë pasi ka marrë dhe pranuar duke poseduar dhe i shet personit tjetër së paku 7 apo 8 herë përkatësisht të miturit F.G. nga fshati Marmull K. Gjakovë monedha prej 100 Euro në shumë prej 25 Euro, e që më pastaj i mituri vazhdon të i shet tek i mituri tjetër B.P, në këtë mënyrë i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme edhe pse në dijeni se paraja është e falsifikuar bënë transportimin e tyre përmes pranimit, duke përdorë dhe poseduar me qëllim të vënies në qarkullim për të vërtetë, edhe pse në dijeni për veprimin e tij të kundërligjshëm, konstatuar edhe nga Raporti i Ekspertimit të Agjencionit të Kosovës për Forenzikë AKF-2022-1125/2022-1000 dt.05.04.2022.

- **Me çka ka kryer veprën penale falsifikim i parasë nga neni 296 parg.2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe neni 296 par.2 dhe parg.5 të KPRK-së, të akuzuarit i:

G J Y K O N

Të akuzuarin A. B.

ME DËNIM ME KUSHT, duke ia vërtetuar dënimin **me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të **verifikimit prej 2 (dy) viteve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Në rast të revokimit të dënimit me kusht në kohëzgjatje 1 (një) viti, do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.23.03.2022 gjerë me dt.12.05.2022.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë Dënimin me Kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari A. B., të mbajnë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

Të akuzuarin K. N.

ME DËNIM ME KUSHT, duke ia vërtetuar dënimin **me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të **verifikimit prej 2 (dy) viteve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Në rast të revokimit të dënimit me kusht në kohëzgjatje 1 (një) viti, do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.23.03.2022 gjerë me dt.12.05.2022.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë Dënimin me Kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari K. N., të mbajnë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

Ndaj të akuzuarve bëhet konfiskimi i monedhave të falsifikuara si: gjashtë (6) monedha nga 100 euro të falsifikuara me numrat serik: – pesë (5) monedha dhe një (1) monedhë me numër, të cilat konfiskohen si të holla të falsifikuara, si objekt i kryerjes së veprës penale.

URDHËROHET që ndaj të akuzuarit A. B. të **KONFISKOHEN**, mjetet monetare në shumën prej **440.00 € (katërqind e dyzet) euro**, në apoena 1x100, 4x50, dhe 7x20, si më poshtë 100 Euro, *me nr. serik, pastaj 50.00 €, me numrat serik si;,,,, pastaj 20 Euro, me numër serik:, 20 Euro, me numër serik:, 20 Euro, me numër serik:, 20 Euro, me numër serik:, 20 Euro, me numër serik:, 20 Euro, me numër serik:, 20 Euro, me numër serik:, si mjete të përfituar nëpërmjet kryerjes së veprës penale.*

Urdhërohet Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të mbajë pasurinën e luajtshme të cekur në pasusin e VII-të të këtij dispozitiv, në kuptim të nenit 284 par.6 të KPP-së.

Detyrohen të akuzuarit A. B. dhe K. N., që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësorë secili veç e veç në shumë prej 50 (pesëdhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit, secili veç e veç shumën prej nga 50 (pesëdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.145/2022, të datës 20.04.2022, kundër të akuzuarve A. B. nga Gjakova dhe K. N. nga fshati O., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 296 prg.2 të KPRK-së.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve të lartcekur, andaj ka propozuar që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari A. B., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, shton se jam penduar dhe se i premtojë gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale.

I akuzuari K. N., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, shton se është penduar për veprën e kryer, i premtun gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla penale, pasi që jam i ri dhe nuk i kam kushtuar rëndësi këtyre veprimeve duke mos i ditur pasojat, i propozon gjykatës që të ketë parasysh një dënim sa më të lehtë.

Prokurorja e Shtetit Dëshire Jusaj, lidhur me pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë së bërë nga të akuzuarit, pasi që të njëjtit pranimin e fajësisë e bënë me vullnet dhe pas konsultimit me mbrojtësit e tyre, dhe se pranimi i fajësisë së këtyre të akuzuarave ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është ngritur aktakuza, andaj gjykatës i propozojë që ta aprovojë pranimin e fajësisë dhe se me rastin e matjes së dënimit krahas rrethanave rënduese të merre parasysh edhe pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. B., av. Meshari Selimaj, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se paraprakisht para se i pandehuri A. të deklarohet lidhur me fajësinë unë si mbrojtësi i tij dhe ai jemi konsultuar dhe kemi diskutuar dhe pajtohëm me pranimin e fajësisë duke marrë për bazë provat materiale të cilat i përmban aktakuza e prokurorisë e që në veçanti i kam sqaruar se kemi të bëjmë me dy elemente të rëndësishme kundër tij siç janë paratë e falsifikuara të cilat i janë gjetur si një provë dhe e dyta deklarimi i bashkëpandehurit të dytë si provë e dytë, ashtu që në mënyrë të vullnetshme i njëjti pasi që i ka kuptuar edhe pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë ka ardhur në përfundim se pranimin e fajësisë do ta bëjë vullnetshëm dhe pa asnjë ndikim, konsiderojë se gjykata duhet ta aprovojë pranimin e fajësisë së bërë nga ana e tij si një pranim i vullnetshëm dhe i bazuar në gjendjen faktike të provave materiale. Po qe se gjykata e aprovon fajësinë për të njëjtin mendojë se duhet të kihen parasysh një mori të rrethanave lehtësuese që e karakterizojnë të njëjtin, duke filluar prej karakteristikave të tij personale, siç

është moshë e re, pra i njëjti ka lindur në vitin dhe ndoshta pa përvoja e tij jetësore ka ndikuar që i njëjti të bie në këtë mënyrë ndesh me ligjin, fakti se i njëjti jo vetëm që asnjëherë nuk ka kryer veprë penale të kësaj natyre por i njëjti asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin për ndonjë veprë penale, faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar për të cilën pranimi e ka një domethënie të veçantë, faktin tjetër se ai është penduar për veprën penale të kryer dhe kërkon falje me premtim se në të ardhmen nuk do të përsërisë asnjë veprë tjetër penale, të ketë parasysh edhe kushtet e tij ekonomike edhe pse në deklarin e tij tha që janë mesatare, ndërsa unë nga familja e tij kam kuptuar se i njëjti ka gjendje të dobët ekonomike dhe të gjitha këto rrethana besojë që gjykata duhet ti ketë parasysh me rastin e vendosjes në këtë çështje penale dhe në kuptim të nenit 72 pika 1.5 e KPRK-së të aplikoj një dënim të zbutur apo të butë ndaj të njëjtit bile edhe ndonjë dënim në kuptim të dispozitës përkatëse ligjore do të mund të zëvendësohej me gjobë nga dënimi me burgim.

Mbrojtësi i të akuzuarit K. N., av.Avdi Rizvanolli lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se pas marrjes së akuzës dhe kontaktit që kam pasur me të mbrojturin tim K. kemi rënë në ujdë të përbashkët që i njëjti pas njoftimit nga ana ime për favoret që i ka pranimi i fajësisë është pajtuar që në mënyrë vullnetare ta pranojë fajësinë edhe se në momentin e kryerjes së veprës penale duke pasur parasysh moshën e tij të re nuk i ka ditur pasojat për veprimet që i ka ndërmarrë. Njëherit theksojë se masa e paraburgimit tek i njëjti ka ndikuar pozitivisht në risocializimin e tij dhe i njëjti tej mase është penduar për veprën e kryer me zotim se në të ardhmen po qe se arrin edhe moshën 100 vjeçare nuk do të ndërmer asnjë veprim i cili bie ndesh me dispozitat ligjore pozitive, për faktin se i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë mendojë dhe vlerësojë se aktvendimi për vazhdimin e paraburgimit ka humbur efektin dhe lus gjyqtarin e çështjes që të mbrojturit tim t'ia ndërpresë paraburgimin nga se i njëjti është duke e vijuar shkollimin, është fundi i vitit shkollor dhe se vazhdimi i mëturjesëm i paraburgimit do të ndikojë në çrregullimin e pikësnyimeve të tij në vazhdimin e një jete normale, të ndershme dhe pa kurrfarë shqetësime si familjare ashtu edhe personale. Andaj i propozojë gjykatës që lidhur me rastin e shqiptimi të dënimit të ketë parasysh që ndaj të njëjtit të shqiptojë një dënim më të butë respektivisht me gjobë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, po ashtu edhe në konsultim me mbrojtësit e tyre av.Meshari Selimaj dhe av.Avdi Rizvanolli, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se të akuzuarit A. B. nga Gjakova dhe K. N. nga fshati O., Komuna e Gjakovës me dashje kanë kryer secili veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 296 paragrafi 2 të KPRK-së.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 296 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që prodhon para të falsifikuara me qëllim për ti vënë në qarkullim si të vërteta, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni parasheh se “Kushdo që duke e ditur se paraja është e falsifikuar merr, vë në qarkullim, transporton, pranon, përdor ose posedon paranë e falsifikuar me qëllim që ta vë në qarkullim si të vërtetë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”. Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata, i ka shpallur fajtor të akuzuarit A. B. nga Gjakova dhe K. N. nga fshati O., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale nge neni 296 paragrafi 2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarit, i ka shpallur fajtor sipas pikës I dhe II aktakuzës, ngase në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 296 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit A. B., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: moshën e tij të re, i punëtor - kamerier, jeton vetë i 5 në familje, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, gjendjen e tij të dobët ekonomike, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilat ngarkohet, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale, faktin se është i gjendjes shumë të dobët ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti pasi që i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimeve nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i

posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit K. N., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: moshën e tij te re, i punësuar si mekanik, jeton vetë i 4 në familje, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, gjendjen e tij ekonomike, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilat ngarkohet, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale, faktin se është i gjendjes shumë të dobët ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti pasi që i njëjti nuk ka qenë i dënuar më parë. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimeve nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi lidhur me mbikëqyrjen e dënimit me kusht nga Shërbimi Sprovues

Vendimin për mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e dënimit me kusht është marrë konform nenit 55 të KPRK-së, duke urdhëruar që dënimin me kusht ta mbikëqyr dhe ta ekzekutojë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë, nga se gjykata konsideron se integrimi i të dënuarve në shoqëri ose përmbushja e dënimit me kusht të shqiptuar nga gjykata arrihet më së miri përmes mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

8. Konfiskimi

Përveç dënimit kryesor, gjykata ndaj të akuzuarve, ka bërë edhe konfiskimin e monedhave të falsifikuara si: gjashtë (6) monedha nga 100 euro të falsifikuara me nr..... – pesë (5) monedha dhe një (1) monedhë me numrat serik:, të cilat konfiskohen si të holla të falsifikuara, si objekt i kryerjes së veprave penale.

Po ashtu Gjykata ka konfiskuar mjetet monetare të akuzuarit A. B., në shumën prej mjetet monetare në shumën prej 440.00 € (katërqind e dyzet) euro, duke Urdhëruar Agjencionin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të mbajë pasurinë e luajtshme të cekur me lartë, në kuptim të nenit 284 par.6 të KPP-së, për faktin se i akuzuari A. B., këto mjete i ka përfutur me anë të shitjes së kartëmonedhave

të falsifikuara, prandaj Gjykata në kuptim të nenin 284 par.1 të KPP-së, e konfiskon pasurinë e luajtshme si mjetë të përfituar nëpërmjet të kryerjes së veprës penale.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.66/22, me datë 25.05.2022

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.